

**RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “ALBSIG”****MAJ 2026**

**Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)

**Shoqëria Administruese:** Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.

**Monedha Bazë:** Lekë

**Politika e Investimit:** Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

**PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT****RREZIK I ULËT***Përfitime zakonisht të ulëta***RREZIK I LARTË***Përfitime zakonisht të larta*

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

**Të dhënat kryesore për Fondin më 31.05.2026**

<b>Vlera Neto e Aktiveve:</b>	<b>1.049.344.024,21 ALL</b>
<b>Çmimi për kuotë:</b>	<b>1.223,0705 ALL</b>
<b>*Kthimi nga Investimit (31 Maj 2025 - 31 Maj 2026):</b>	<b>4.10%</b>


*\*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*

**KOSTOT DHE TARIFAT**

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

**SHPËRNDARJA E AKTIVEVE**

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emtuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	996,293,568.85	<b>94,94</b>
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	53,050,455.36	<b>5,06</b>

**ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.**


Kthimi vjetorë neto rezulton 4.10% për periudhën 31 Maj 2025 - 31 Maj 2026.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 31 Maj 2026. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **07.02.2020**.

Albsig	5Y	3Y	2Y	1Y
	<b>Norma Vjetore e Kthimit</b>	3.60%	4.12%	4.16%